<p>a) emrin, mbiemrin, adresën dhe numrin e telefonit të kryetarit të partisë;</p> <p>b) emrin, mbiemrin, adresën dhe numrin e telefonit të përfaqësuesit të autorizuar financiar të partisë;</p> <p>c) emrin, mbiemrin, adresën dhe numrin e telefonit të personit të autorizuar, për të komunikuar në emër të partisë me KQZ-në;</p> <p>d) numrin e telefonit, adresën elektronike dhe adresën postare të zyrës qendrore të partisë;</p> <p>e) deklaratën e nënshkruar nga kryetari i partisë se do të respektojë dhe do t'i përmbahet ligjit;</p> <p>f) Programin e partisë</p> <p>g) statutin e partisë;</p> <p>h) akronimin dhe shenjën e partisë;</p> <p>i) deklaratën e fundit financiare të partisë;</p> <p>j) aktin e themelimit të partisë politike;</p> <p>k) emrin dhe adresën e së paku 500 anëtarëve të partisë, të cilët banojnë në Kosovë dhe të cilët gjenden në LV në Kosovë.</p> <p>41.4. Zyra i shqyrton aplikimet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga pranimi i tyre dhe brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i rishikimit të çfarëdo çështjeje që kërkon sqarim apo ndryshim në formën e aplikimit.</p> <p>41.5. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga pranimi i aplikimit, Zyra e njofton KQZ-në për statusin e aplikimit, duke rekomanduar regjistrimin, duke rekomanduar mos</p>	<p>form established by CEC rule as required by the Office, and shall include the following:</p> <p>a) name, surname, address and telephone number of the president of the Party;</p> <p>b) name, surname, address and telephone number of the authorized financial agent of the party;</p> <p>c) name, surname, address and telephone number of the person authorized to communicate with the CEC on behalf of the Party;</p> <p>d) telephone number and the postal address of the headquarter of the party;</p> <p>e) a statement signed by the President of the Party to respect and abide by the law;</p> <p>f) party manifesto</p> <p>g) statute of the Party;</p> <p>h) the acronym and seal of the Party;</p> <p>i) the most recent financial statement of the Party;</p> <p>j) the founding act of the Party;</p> <p>k) name and address of at least 500 party members who are residing in Kosovo and who are found on the Kosovo VL.</p> <p>41.4. The Office shall review applications within ten (10) days of receipt and inform the authorized representative of the party within five (5) of the completion of the review of any matter that requires clarification or change in the application form.</p> <p>41.5. Within thirty (30) days of receiving</p>	<p>Kancelarije i treba da uključuju sledeće:</p> <p>a) ime, prezime, adresu i broj telefona predsednika stranke;</p> <p>b) ime, prezime, adresu i broj telefona ovlašćenog finansijskog predstavnika stranke;</p> <p>c) ime prezime, adresu i broj telefona ovlašćenog lica za komunikaciju u ime stranke sa CIK-om;</p> <p>d) broj telefona i elektronsku adresu i poštansku adresu centralne kancelarije stranke;</p> <p>e) izjavu potpisanu od predsednika stranke da će poštovati i pridržavati se zakona;</p> <p>f) program stranke;</p> <p>g) statut stranke;</p> <p>h) skraćenicu i oznaku stranke;</p> <p>i) zadnju finansijsku izjavu stranke;</p> <p>j) akt osnivanja političke stranke;</p> <p>k) ime i adresu najmanje 500 članova stranke koji žive na Kosovu i nalaze se u BS na Kosovu.</p> <p>41.4. Kancelarija razmatra aplikacije u roku od deset (10) dana od njihovog prijema i u roku od pet (5) dana od završetka preispitivanja bilo kog pitanja koje zahteva objašnjenje ili izmenu u formi aplikacije.</p> <p>41.5. U roku od trideset (30) dana od prijema aplikacije, Kancelarija obaveštava CIK o statusu aplikacije, preporučujući registraciju, preporučujući ne registraciju, ili pojašnjavajući druge oblasti koje mogu zahtevati dodatna objašnjenja.</p> <p>41.6. CIK ne registruje politički subjekt pod istim ili sličnim imenom ili</p>
---	---	--

<p>regjistrimin, ose duke saktësuar fusha të tjera që mund të kërkojnë sqarime shtesë.</p> <p>41.6. KQZ-ja nuk e regjistron subjektin politik me emër apo akronim që është i njëjtë, i ngjashëm apo është i ngatërrueshëm dhe mashtrues me emrin apo akronimin, me të cilin është certifikuar më herët një subjekt tjetër politik dhe që nuk është në pajtim me dispozitat ligjore dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.</p> <p>41.7. Partia politike konsiderohet automatikisht e certifikuar në kohën e zgjedhjeve dhe pasi që të plotësojë kërkesën në përputhje me këtë ligj, përveç nëse e informon Zyrën ndryshe.</p> <p>41.8. Partia politike e regjistruar ose cilido aplikues tjetër për certifikim, në përputhje me këtë ligj, konsiderohet si subjekt politik. Zyra krijon dhe mban kuti postare për secilin subjekt politik të certifikuar nga KQZ-ja.</p>	<p>the application, the Office shall inform the CEC of the status of the application, recommending to register, recommending not to register, or specifying areas that may require further clarification.</p> <p>41.6. The CEC shall not certify a Political Entity under a name or acronym that is the same as, or in the judgment of the CEC, is confusingly or misleadingly similar to, the name or acronym under which a different Political Entity has previously been certified, or does not comply to the legal requirements or the Constitution of the Republic of Kosovo.</p> <p>41.7. A Political Party shall be considered automatically certified at the time of elections and after it fulfills the requirements as per this law, unless it otherwise informs the Office.</p> <p>41.8. A registered Political Party or any other applicant for certification in accordance with this law shall be deemed a political entity. The Office shall establish and maintain a mailbox for each Political Entity certified by the CEC.</p>	<p>skraćenicom ili koje je zbunjujuće ili obmanjujuće sa imenom ili skraćenicom prema kojima je ranije sertifikovan jedan drugi politički subjekt i koje nije u skladu sa zakonskim odredbama i Ustavom Republike Kosova.</p> <p>41.7. Politička stranka smatra se automatski sertifikovanom u vremenu izbora i nakon ispunjavanja zahteva u skladu sa ovim zakonom, osim ukoliko drugačije obaveštava Kancelariju.</p> <p>41.8. Registrovana politička stranka ili bilo koji drugi aplikant za sertifikaciju u skladu sa ovim zakonom smatra se pravnim subjektom. Kancelarija uspostavlja i vodi poštansku kutiju za svakog sertifikovanog političkog subjekta od strane CIK-a.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 42</p> <p style="text-align: center;">Auditimet e deklaratave financiare të partive politike</p> <p>42.1. Një parti politike e regjistruar dorëzon në Zyrë një deklaratë financiare vjetore në pajtim me Ligjin për financimin e subjekteve politike dhe rregullat e KQZ-së.</p>	<p style="text-align: center;">Article 42</p> <p style="text-align: center;">Auditing of Financial Statements of Political Parties</p> <p>42.1. A political party shall submit at the Office annual financial statement in compliance with the Law on Financing Political Entities and CEC rules.</p>	<p style="text-align: center;">Član 42</p> <p style="text-align: center;">Revizije finansijskih deklaracija političkih stranaka</p> <p>42.1. Registrovana politička stranka podnosi Kancelariji godišnju finansijsku deklaraciju, u skladu sa zakonom o finansiranju političkih subjekata i pravila CIK-a.</p>

<p>42.2. Zyrtari i autorizuar financiar i partisë dhe kryetari i partisë, janë ligjërisht përgjegjës për saktësinë e të gjitha informatave të dorëzuara në Zyrë, ashtu siç kërkohet me këtë ligj.</p>	<p>42.2. The authorized financial officer of the party and the president of the party shall be legally responsible for the accuracy of all information submitted to the Office as required by this law.</p>	<p>42.2. Ovlašćeni finansijski službenik stranke i predsjednik stranke su pravno odgovorni o tačnosti svih dostavljeni informacija u Kancelariji, kao što se ovim zakonom zahteva.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 43 Aplikimi për Certifikim nga subjektet politike</p>	<p style="text-align: center;">Article 43 Certification Application by Political Entities</p>	<p style="text-align: center;">Član 43 Aplikacija za sertifikaciju od političkih subjekata</p>
<p>43.1. Subjekti politik duhet të certifikohet nga KQZ-ja për pjesëmarrje në zgjedhje. 43.2. Aplikimet për certifikim mund të dorëzohen në çdo kohë gjatë orëve të rregullta të punës deri 60 (gjashtëdhjetë) ditë para zgjedhjeve. Asnjë aplikim nuk mund të merret në konsideratë nga Zyra në mes 60 (gjashtëdhjetë) ditë para zgjedhjeve dhe ditës së zgjedhjeve. 43.3. Nëse partia politike e regjistruar që dëshiron të certifikohet përmes koalicionit, atëherë e njofton Zyrën brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga shpallja e ditës së zgjedhjeve.</p>	<p>43.1. In order to participate in elections, a Political Entity must be certified by the CEC. 43.2. Application for certification may be submitted at any time during normal working hours up to sixty (60) days prior to election. No application shall be taken into consideration by the Office between sixty (10) days prior to election and the Election Day. 43.3. If a registered Political Party is seeking certification as a coalition, it must notify the Office within fifteen (15) days from the day of declaration of Election Day.</p>	<p>43.1. Politički subjekat mora biti sertifikovan od CIK-a za učešće na izborima. 43.2. Aplikacije za sertifikaciju mogu se podneti u bilo koje vreme tokom redovnih radnih časova do šesdeset (60) dana pre izbora. Nijedna aplikacija se ne može uzeti u obzir od strane Kancelarije između šesdeset (60) dana pre izbora i na dan izbora. 43.3. Ukoliko registrovana politička stranka koja želi da se certifikuje preko koalicije, u tom slučaju obaveštava Kancelariju u roku od petnaest (15) dana pre objavljivanja dana izbora.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 44 Certifikimi i një subjekti politik</p>	<p style="text-align: center;">Article 44 Certification of a Political Entity</p>	<p style="text-align: center;">Član 44 Certifikacija političkog subjekta</p>
<p>44.1. KQZ-ja e certifikon subjektin politik, me të drejtë pjesëmarrjeje, nëse i njëjti e dorëzon aplikimin e plotësuar, në formën e përkthuar dhe në datën e vendosur nga rregullat e KQZ-së. Këto aplikime shoqërohen me të gjithë dokumentacionin</p>	<p>44.1. The CEC shall certify an eligible Political Entity if it submits a complete application, in the form prescribed and by a date established by a CEC rule. Such application shall be accompanied by all supporting documentation required under</p>	<p>44.1. CIK certifikuje politički subjekat s pravom učešća ukoliko isti predaje popunjenu aplikaciju, u propisanoj formi i u datumu određenim od pravila CIK-a. Ovim aplikacijama se prilaže sva podržna dokumentacija, tražena ovim članom, i to:</p>

<p>e mbështetur të kërkuar nga ky nen si në vijim:</p> <p>a) Certifikata e Regjistrimit (numri personal në rastin e kandidatëve individualë);</p> <p>b) emri, mbiemri, adresa dhe numri i telefonit të kryetarit të subjektit ku kjo është e zbatueshme dhe përfaqësuesit të autorizuar dhe numri i telefonit të zyrës qendrore të subjektit politik;</p> <p>c) kopja e shenjës së partisë, apo në rast koalicionesh, kopja e shenjës e të gjitha partive politike që janë në koalicion dhe çfarëdo shenje të vetë koalicionit;</p> <p>d) emri, mbiemri, adresa dhe numri i telefonit i zyrtarit financiar të subjektit;</p> <p>e) emri, mbiemri, adresa dhe numri i telefonit i personit të ngarkuar me procesin zgjedhor në emër të subjektit;</p> <p>f) deklarata e nënshkruar nga kryetari i partisë, apo bartësi i listës për subjekte të tjera që zotohen për të respektuar dhe vepruar në përputhje me këtë ligj;</p> <p>g) në rast të koalicionit, një deklaratë e nënshkruar nga kryetari i secilës parti politike të regjistruar, e cila merr pjesë në koalicion, përmes së cilës jepet pëlqimi për të marrë pjesë, duke bërë me dije mënyrën përmes të cilës kandidatët do të radhiten në fletëvotim, në mesin e anëtarëve të koalicionit dhe që zotohen për të respektuar dhe vepruar në pajtim me këtë ligj;</p> <p>h) në rastin e nismës qytetare, numrin e letërnjoftimit të udhëheqësit të nismës,</p>	<p>this article as follows:</p> <p>a) a Registration Certificate (ID number in case of independent candidates);</p> <p>b) name, surname, address, and telephone number of the Entity's President where applicable, and the authorized representative and the telephone number of the headquarters of the political entity;</p> <p>c) a copy of the party's seal, or in case of coalitions, a copy of the seal of all political parties in the coalition;</p> <p>d) name, surname, address, and telephone number of the Financial Officer of the Entity;</p> <p>e) name, surname, address, and telephone number of a person authorized to deal with electoral process on the Entity's behalf;</p> <p>f) statement signed by the President of the Party, or bearer of the list for other Entities committing to respect and abide by this Law;</p> <p>g) in the case of a coalition, , a statement signed by the president of each registered political party participating in the coalition consenting to participate, indicating the manner in which the candidates shall be distributed between the members of the coalition on the ballot, and committing to respect and abide by this Law;</p> <p>h) in the case of citizens initiative, the ID number of the leader of the initiative, the authorized representative,</p>	<p>a) Certifikat o registraciji (lični broj u slučaju individualnih kandidata);</p> <p>b) ime, prezime, adresa i broj telefona predsednika subjekta gde je to primenjivo i ovlašćenog predstavnika i broj telefona centralne kancelarije političkog subjekta;</p> <p>c) kopija oznake stranke, ili u slučaju koalicija, kopija oznake svih političkih stranaka koje su u koaliciji i bilo koja oznaka same koalicije;</p> <p>d) ime, prezime, adresa i broj telefona finansijskog službenika subjekta;</p> <p>e) ime, prezime, adresa i broj telefona lica zaduženog izbornim procesom na ime subjekta;</p> <p>f) potpisana izjava od strane predsednika stranke, ili nosioca liste za ostale subjekte koji se obavezuju da poštuju i da postupaju u skladu sa ovim zakonom;</p> <p>g) u slučaju koalicije, jedna potpisana izjava od strane predsednika svake registrovane političke stranke koja učestvuje u koaliciji, preko koje se daje saglasnost za učešće, stavljajući do znanja način preko kojeg će se kandidati poređati u glasački listić među članovima koalicije i obavezuju se da poštuju i deluju u skladu sa ovim zakonom;</p> <p>h) u slučaju građanske inicijative, broj lične karte vođe inicijative, ovlašćenog predstavnika i ovlašćenog finansijskog predstavnika. U slučaju nezavisnog kandidata ili građanske inicijative,</p>
--	---	---

<p>përfaqësuesin e autorizuar dhe përfaqësuesin financiar të autorizuar. Në rast të kandidatit të pavarur apo nismës qytetare, kandidati apo udhëheqësi i nismës, po ashtu mund të shërbejë si përfaqësues i autorizuar dhe përfaqësues financiar;</p> <p>i) emri, mbiemri, adresa dhe numri i telefonit të udhëheqësit të listës së koalicionit, përfaqësuesit dhe përfaqësuesit financiar;</p> <p>j) në rast të koalicionit, një kopje e çfarëdo shenje të koalicionit;</p> <p>k) Zyra njoftohet për çfarëdo ndryshimi të kryetarit të partisë politike apo zyrtarit për financa, brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas bërjes së ndryshimeve.</p> <p>44.2. Subjekti politik dorëzon certifikatën e pagesës bashkë me aplikacion, siç është paraparë me rregullat e KQZ-së.</p> <p>44.3. Përveç përjashtimeve të përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni, secili aplikim për certifikim përfshin numrin e nevojshëm të nënshkrimeve siç parashihet me rregullën e KQZ-së.</p> <p>44.4. Partia politike që ka marrë së paku një (1) ulëse në Kuvendin e Kosovës në zgjedhjet e fundit të llojit të njëjtë, nuk kërkohet të dorëzojë nënshkrimet në mbështetje të aplikimit të saj për certifikim në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.</p> <p>44.5. Personi mund të japë nënshkrimin e tij/saj në mbështetje të vetëm një subjekti politik për zgjedhje.</p> <p>44.6. Çdo subjekt politik në kërkesën e tij</p>	<p>and the authorized financial representative. In the case of an independent candidate or citizens initiative, the candidate or the leader of the initiative may also serve as authorized representative and financial representative;</p> <p>i) name, surname, address and telephone number of the leader of the list of the coalition, representative and financial representative;</p> <p>j) in the case of a coalition, a copy of any seal of the coalition.</p> <p>k) the Office shall be informed of any change in Political Party's president or financial officer shall be notified within five (5) working days of changes.</p> <p>44.2. A Political Entity shall submit with its application a certification fee as defined by CEC rules.</p> <p>44.3. In addition to exclusions under paragraph 4 of this article, each application for certification shall have the signatures in the number as specified by the CEC rule.</p> <p>44.4. A Political Party that gained at least one (1) seat in the Kosovo Assembly in the last election of the same type is not required to submit signatures in support of its application for certification in elections for the Assembly of Kosovo.</p> <p>44.5. A person may give his or her signature in support of only one Political Entity per election.</p> <p>44.6. Each Political Entity shall indicate in its application whether it wishes to contest</p>	<p>kandidat ili vođa inicijative mogu takođe služiti kao ovlašćeni predstavnik i finansijski predstavnik;</p> <p>i) ime, prezime, adresa i broj telefona predvodnika liste koalicije, predstavnika i finansijskog predstavnika;</p> <p>j) u slučaju koalicije, jedna kopija bilo kakve oznake koalicije;</p> <p>k) kancelarija se obaveštava o bilo kakvoj promeni predsednika političke stranke ili zvaničnika za finansije u roku od pet (5) radnih dana nakon izvršenja promena.</p> <p>44.2. Politički subjekat dostavlja sertifikat isplate uz aplikaciju, kao što je propisano pravilima CIK-a.</p> <p>44.3. Osim izuzetaka utvrđenih u stavu 4. ovog člana, svaka aplikacija za sertifikaciju uključuje potreban broj potpisa, kako je predviđeno pravilom CIK-a.</p> <p>44.4. Politička stranka koja je dobila najmanje jedno (1) mesto u Skupštini Kosova na zadnjim izborima iste vrste ne zahteva se da dostavlja potpise u podršci njene aplikacije za sertifikaciju na izborima za Skupštinu Kosova.</p> <p>44.5. Osoba može dati njegov/njen potpis u podršci samo jednog političkog subjekta za izbore.</p> <p>44.6. Svaki politički subjekat u njegovom zahtevu ističe da li želi da ulazi u takmičenju da dobije neko od zagarantovanih mesta za predstavljanje Srba i ostalih ne – većinskih zajednica</p>
--	---	--

<p>tregon nëse dëshiron të hyjë në garë për të fituar ndonjërin prej vendeve të garantuara për përfaqësim të serbëve dhe komuniteteve tjera jo-shumicë të Kosovës, sipas nenit 64 të Kushtetutës.</p> <p>44.7. Çdo dështim në përmbushjen e kërkesave të këtij neni i jep të drejtë KQZ-së të pezullojë procesin e aplikimit. Përveç kërkesave të certifikimit të këtij kapitulli, më lartë, KQZ-ja, me pranimin e aplikimit për certifikim nga subjekti politik, përfshirë edhe partinë politike të regjistruar, kërkon nga PZAP-ja të japë konfirmim me shkrim se subjekti politik që aplikon ka paguar plotësisht gjrobat në lidhje me cilitdo zgjedhje të mëparshme dhe të konfirmojë se nuk ka borxhe tjera të papaguara.</p> <p>44.8. Të gjitha kërkesat për të tërhequr një subjekt të certifikuar politik nga zgjedhjet i dorëzohen KQZ-së.</p>	<p>any of the seats guaranteed for the representation of Kosovo Serb and other non-majority communities under Article 64 of the Constitution.</p> <p>44.7. Any failure to comply with the requirements of this Article shall entitle the CEC to suspend the application process. In addition to the certification requirements of this Chapter, above, the CEC shall, on receipt of a certification application by a political entity, including a registered political party, require the ECAC to provide it with a written confirmation that the political entity applying has fully paid any fines in relation to any previous election and confirm that there are no financial or other outstanding liabilities.</p> <p>44.8. All requests to withdraw a certified political entity from the election shall be submitted to the CEC.</p>	<p>Kosova, shodno člana 64. Ustava.</p> <p>44.7. Svaki neuspeh u ispunjavanju zahteva ovog člana daje za pravo CIK-u da obustavi proces aplikacije. Osim zahteva sertifikacije ovog, gore navedenog Poglavlja, CIK, prijemom aplikacije za sertifikaciju od političkog subjekta, uključujući i registrovanu političku stranku, traži od IPŽP da daje pismenu potvrdu da je politički subjekat koji aplicira u celosti uplatio novčane kazne u odnosu na bilo koje ranije izbore i da potvrdi da nema drugih ne podmirenih dugova.</p> <p>44.8. Svi zahtevi za povlačenje sertifikovanog političkog subjekta iz izbora podnose se CIK-u.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 45</p> <p style="text-align: center;">Shqyrtimi i aplikimeve për certifikim</p> <p>45.1. Zyra shqyrton të gjitha aplikimet për certifikim dhe nëse përcakton se subjekti politik nuk ka plotësuar të gjitha kërkesat e paraparë me nenin 43 dhe 44 të këtij ligji, atëherë Zyra, brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të aplikimit për certifikim, dërgon një njoftim me të cilin e informon subjektin politik për arsyen ose arsyet pse aplikimi i tij nuk është i mjaftueshëm.</p> <p>45.2. Aplikuesi i cili pranon njoftimin</p>	<p style="text-align: center;">Article 45</p> <p style="text-align: center;">Review of Certification Applications</p> <p>45.1. The Office shall review each application for certification and if it determines that a Political Entity has not satisfied all of the criteria set out in the Article 43 and 44 of this law, then the Office shall within ten (10) days after the receipt of the application send a notice informing the political Entity of the reason or reasons why its application for certification is not sufficient.</p>	<p style="text-align: center;">Član 45</p> <p style="text-align: center;">Razmatranje aplikacija za sertifikaciju</p> <p>45.1. Kancelarija razmatra sve aplikacije za sertifikaciju i, ukoliko utvrđuje da politički subjekat nije ispunjavao sve zahteve propisane članom 43. i 44. ovog zakona, onda Kancelarija u roku od deset (10) dana nakon prijema aplikacije za sertifikaciju dostavlja jedno obaveštenje, kojim informiše politički subjekat o razlogu ili razlozima zašto je njegova aplikacija nedovoljna.</p>

<p>sipas nenit 41.4 të këtij ligji, ka afat 5 (pesë) ditë pune, për të dorëzuar aplikimin e korigjuar apo një shpjegim që adreson brengat e identifikuar në njoftim.</p> <p>45.3. Zyra i bën rekomandim me shkrim KQZ-së për apo kundër miratimit të secilit aplikim që pranon brenda 5 (pesë) ditëve nga pranimi i dokumentacionit të plotë. Rekomandimet përmbajnë shpjegim të shkruar për secilin kriter. Asnjë parti nuk certifikohet nëse nuk i plotëson kriteret e përcaktuara.</p> <p>45.4. Pas pranimit të rekomandimit nga Zyra, KQZ-ja e miraton ose refuzon aplikimin për certifikim, brenda 7 (shtatë) ditëve të punës.</p> <p>45.5. Pas vendimit të KQZ-së, Zyra e njofton menjëherë aplikuesin me shkrim rreth statusit të aplikimit, dhe në rast të refuzimit, ofron arsyetimin për refuzim dhe e këshillon aplikuesin që ka të drejtën e ankesës nga momenti i njoftimit me shkrim nga ana e Zyrës në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve.</p> <p>45.6. Zyra e njofton me shkrim aplikuesin në afat prej 48 (dyzet e tetë) orëve.</p>	<p>45.2. An applicant who receives a notice as per Article 41.4 of this law, shall have five (5) working days to submit an amended application or an explanation addressing concerns raised in the notice.</p> <p>45.3. The Office shall make a written recommendation to the CEC for or against the approval of each application it receives within five (5) days from receiving full documentation. The recommendation shall contain written explanation for each criteria. No party shall be certified unless it fulfills all of the criteria set forth.</p> <p>45.4. After receiving a recommendation from the Office, the CEC shall either approve or reject the application for certification within seven (7) working days.</p> <p>45.5. After the CEC decision, The Office shall inform the applicant regarding the registration status and in case of refusal, shall provide grounds for refusal and advises the applicant with the right to complaint from the moment of written notice by the Office, at the ECAC within forty-eight (48) hours.</p> <p>45.6. The Office shall inform the applicant in writing within forty-eight (48) hours.</p>	<p>45.2. Aplikant koji dobija obaveštenje shodno člana 41.4 ovog zakona, ima rok od pet (5) radnih dana da predaje korigovanu aplikaciju ili objašnjenje koje adresira identifikovane zabrinutosti u obaveštenju.</p> <p>45.3. Kancelarija podnosi pismenu preporuku CIK-u za ili protiv usvajanja svake aplikacije koju prima u roku od pet (5) dana od prijema potpune dokumentacije. Preporuke sadržavaju pismeno objašnjenje za svaki kriterijum. Nijedna stranka se ne certifikuje ukoliko ne ispunjava utvrđene kriterijume.</p> <p>45.4. Nakon prijema preporuke od Kancelarije, CIK usvaja ili odbija aplikaciju za sertifikaciju u roku od sedam (7) radnih dana.</p> <p>45.5. Nakon odluke CIK-a, Kancelarija odmah obaveštava aplikanta u pisanoj formi o statusu aplikacije i u slučaju odbijanja, daje obrazloženje za odbijanje i savetuje aplikanta da ima pravo žalbe od trenutka pismenog obaveštenja od strane Kancelarije u IPŽP u roku od četrdeset i osam (48) časova.</p> <p>45.6. Kancelarija pismeno obaveštava aplikanta u roku od u roku od četrdeset i osam (48) časova.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 46 Partitë Politike</p> <p>46.1. Partia politike mund të certifikohet për pjesëmarrje në zgjedhje, nëse dëshmon se regjistrimi në bazë të legjislacionit në</p>	<p style="text-align: center;">Article 46 Political Parties</p> <p>46.1. A Political Party may be certified to participate in an election, provided that its registration under the applicable law is not</p>	<p style="text-align: center;">Član 46 Političke stranke</p> <p>46.1. Politička stranka se može sertifikovati za učešće na izborima,</p>

<p>fuqi nuk është nën pezullim.</p> <p>46.2. Zyra e informon KQZ-në rreth statusit të regjistrimit të secilës parti politike aplikuese, para përfundimit të procedurës së certifikimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 47 Koalicionet</p> <p>47.1. 2 (dy) apo më shumë parti politike që kanë të drejtë për t'u certifikuar si subjekte politike, mund të aplikojnë së bashku në KQZ për certifikim që të garojnë në zgjedhje si koalicion nën një emër të përbashkët, në baze të marrëveshjes së tyre të brendshme, e cila parasheh, themelimin, funksionimin, të drejtat dhe obligimet, si dhe shpërbërjen.</p> <p>47.2. Një koalicionin është një subjekt politik nga dita kur është certifikuar nga KQZ-ja, e deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve. Partia politike nuk mund të tërhiqet nga koalicioni, pasi që të jetë certifikuar, derisa rezultatet e zgjedhjeve të certifikohen.</p> <p>47.3. Pas shpërbërjes së koalicionit, secila nga partitë politike të regjistruara, të cilat kanë qenë anëtare të koalicionit, janë përgjegjëse për një ndarje të të drejtave dhe detyrimeve, në bazë të marrëveshjes për koalicion. Nëse nuk ka marrëveshje, të gjitha ndarjet bëhen në mënyrë proporcionale, për të gjitha borxhet të shkaktuara nga</p>	<p>under suspension.</p> <p>46.2. The Office shall inform the CEC regarding the registration status of each applicant Political Party prior to the conclusion of the certification procedure.</p> <p style="text-align: center;">Article 47 Coalitions</p> <p>47.1. Two (2) or more Political Parties eligible to be certified as Political Entities may apply jointly at the CEC for certification to contest in election as a coalition under a unified name based on their internal agreement that regulates establishment, the functioning, the rights and obligations as well as disbandment.</p> <p>47.2. A Coalition is a single Political Entity from the day the Coalition is certified by the CEC until the results of the election are certified. A Political Party may not withdraw from a Coalition once it has been certified, until the results of the election are certified.</p> <p>47.3. Upon dissolution of a Coalition, each of the registered Political Parties that were members of the Coalition shall be responsible for a share of rights and Liabilities proportional to the agreement of the Coalition. A proportional sharing (translation: <i>of rights and liabilities?</i>) shall take place in the event where no agreement exists. including any liabilities incurred by the coalition in</p>	<p>ukoliko dokaže da registracija pod važećim zakonodavstvom nije pod suspenzijom.</p> <p>46.2. Kancelarija obaveštava CIK o statusu registracije svake političke stranke koja je aplicirala pre okončanja procedure za sertifikaciju.</p> <p style="text-align: center;">Član 47 Koalicije</p> <p>47.1. Dve (2) ili više političke stranke koje imaju pravo da se sertifikuju kao politički subjekti mogu aplicirati zajedno u CIK za sertifikaciju kako bi se takmičili na izborima kao koalicija pod jednim zajedničkim imenom na osnovu njihovog internog sporazuma, koji predviđa osnivanje, funkcionisanje, prava i obaveze kao i raspad.</p> <p>47.2. Jedna koalicija je jedan politički subjekat od dana kada je sertifikovana od CIK-a pa do sertifikacije izbornih rezultata. Politička stranka ne može istupati iz koalicije nakon sertifikacije, do sertifikacije izbornih rezultata.</p> <p>47.3. Nakon raspada koalicije, svaka od registrovanih političkih stranaka, koje su bile članice koalicije, odgovorne su za podelu prava i obaveza na osnovu sporazuma za koaliciju. Ukoliko nema sporazuma, sva podela se vrši proporcionalno, svi prouzrokovani dugovi od koalicije shodno sporazuma o koaliciji, uključujući i neisplaćene novčane kazne</p>
--	---	--

<p>koalicioni, konform marrëveshjes për koalicionin, përfshirë gjobat e papaguara të ngarkuara nga KQZ-ja apo PZAP-i, përveç atyre të shqiptuara ndaj kandidatëve individualisht.</p> <p>47. 4. Nëse në marrëveshjen e koalicionit nuk është paraparë ndarja e borxheve (gjobave) të shkaktuara nga partnerët e koalicionit, me këtë dispozitë të përcaktohet në përqindje ndarja e borxheve.</p> <p>47.5. Partia politike që është anëtare e koalicionit, nuk mund të marrë pjesë si anëtare në një koalicion tjetër apo si subjekt politik i veçantë në të njëjtat zgjedhje.</p>	<p>conformity with coalition agreement, including outstanding fines imposed by the CEC or the ECAC, excluding those issued to individual candidates.</p> <p>47. 4. If the coalition agreement does not regulate sharing of liabilities (fines) incurred by the coalition partners, this provision should specify a share in liabilities in terms of percentage.</p> <p>47.5. A political party that is a member of a Coalition cannot participate as a member of another Coalition or as a separate political party in the same election.</p>	<p>izrečene od CIK-a ili IPŽP-a, osim onih izrečenim kandidatima pojedinačno.</p> <p>47.4. Ukoliko u sporazumu koalicije nije predviđena podela dugova (kazni) prouzrokovanih od koalicionih partnera, ovom odredbom određuje se procentualna podela dugova.</p> <p>47.5. Politička stranka koja je član koalicije ne može da učestvuje kao član jedne druge koalicije ili kao poseban politički subjekt na istim izborima.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 48 Nisma qytetare</p>	<p style="text-align: center;">Article 48 Citizen's Initiative</p>	<p style="text-align: center;">Član 48. Gradanska inicijativa</p>
<p>48.1. Nismë qytetare është një subjekt politik nga dita e certifikimit nga KQZ, deri kur të dorëzojë raportin përfundimtar të publikimit financiar të fushatës, sipas nenit 68 të këtij ligji.</p> <p>48.2 Secili kandidat i certifikuar i listës së nismës qytetare është personalisht përgjegjës për ndarje të barabartë të gjobave të ngarkuara mbi nismën qytetare nga KQZ-ja apo PZAP-i.</p>	<p>48.1. A Citizen's Initiative is a single Political Entity from the day the Initiative is certified by the CEC until the moment the Citizen's Initiative submits the Campaign Financial Disclosure Report, under Article 68 of this law.</p> <p>48.2 Each candidate on the certified candidate list of a Citizens' Initiative shall be personally responsible for an equal share of any fines imposed on the Citizens' Initiative by the CEC or the ECAC.</p>	<p>48.1. Gradanska inicijative je politički subjekat od dana sertifikacije od CIK-a do dostavljanja završnog finansijskog izveštaja kampanje, shodno člana 68. ovog zakona.</p> <p>48.2. Svaki sertifikovani kandidat spiska građanske inicijative je lično odgovoran za podjednaku podelu kazni izrečenih prema građanskoj inicijativi od strane CIK-a ili IPŽP-a.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 49 Kandidatët e pavarur</p> <p>49.1. Një person që ka të drejtë të jetë kandidat, mund të aplikojë në KQZ që të certifikohet si kandidat i pavarur, që të garojë në zgjedhje.</p> <p>49.2. Kandidati i pavarur nuk mund që në të njëjtat zgjedhje, të certifikohet si kandidat për një parti politike, koalicion apo nismë qytetare.</p> <p>49.3. Një kandidat i pavarur nuk mund të tërheqë kandidaturën e tij apo saj, para certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.</p>	<p style="text-align: center;">Article 49 Independent Candidates</p> <p>49.1. Any person eligible to be a candidate, may apply at the CEC for certification to contest in election as an independent candidate.</p> <p>49.2. An independent candidate may not, in the same election, seek certification as a candidate for a Political Party, Coalition or Citizens' Initiative.</p> <p>49.3. An independent candidate may not withdraw his or her candidacy before the certification of the election results.</p>	<p style="text-align: center;">Član 49. Nezavisni kandidati</p> <p>49.1. Lice koje ima pravo da bude kandidat, može da aplicira u CIK-u da bude sertifikovan kao nezavisni kandidat za učešće na izborima.</p> <p>49.2. Nezavisni kandidat ne može da se, na istim izborima, certifikuje kao kandidat za političku stranku, koaliciju ili građansku inicijativu.</p> <p>49.3. Nezavisni kandidat ne može da povuče njegovu ili njenu kandidaturu pre sertifikacije izbornih rezultata.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 50 Emrat e subjekteve politike</p> <p>50.1. Subjektet politike që aplikojnë për certifikim me emra apo akronime fyese kundërkushtetuese, që nxisin urrejtje apo që janë të njëjta, apo aq të ngjashme sa që me siguri se do të shkaktojnë ngatërrim apo çorientojnë votuesit, KQZ-ja vendos se cili subjekt ka të drejtën për t'u certifikuar me emrin dhe akronimin e caktuar. Në vendimin se cili subjekt politik ka të drejtën për t'u certifikuar, nën cilin emër dhe akronim, KQZ-ja ka parasysh datën kur secili subjekt ka dorëzuar aplikimin e tij në KQZ dhe përdorimin paraprak të emrave dhe akronimeve.</p> <p>50.2. Asgjë në këtë nen nuk e pamundëson certifikimin e kandidatëve të pavarur me emrin ligjor të tij apo saj. Në rast se emrat</p>	<p style="text-align: center;">Article 50 Names of Political Entities</p> <p>50.1. Political Entities which apply for certification under names or acronyms that offensive or unconstitutional or incite hatred, or are the same, or so similar that they are likely to cause confusion or mislead voters, the CEC shall decide which Entity has the right to be certified under the name or acronym. In deciding which Political Entity has the right to be certified under a name or acronym, the CEC shall consider the date on which each Entity submitted its application to the CEC and each Entity's previous use of the names or acronyms.</p> <p>50.2. Nothing in this article precludes the certification of an independent candidate under his or her legal name. Where candidate names are the same, the CEC</p>	<p style="text-align: center;">Član 50 Imena političkih subjekata</p> <p>50.1. Politički subjekti koji apliciraju za sertifikaciju sa uvredljivim protiv ustavnim imenima ili skraćenicama koje podstiču mržnju ili su ista, ili toliko slična da nedvosmisleno dovode do zablude ili dezorijentišu glasače, CIK odlučuje koji subjekat ima pravo da bude sertifikovan pod određenim imenom i skraćenicom. U odluci koji subjekat ima pravo da bude sertifikovan pod kojim imenom i skraćenicom, CIK ima u vidu datum kada je svaki od subjekta podneo svoju aplikaciju u CIK-u i prethodno korišćenje imena i skraćenice.</p> <p>50.2. Ništa kod ovog člana ne onemogućuje sertifikaciju nezavisnih</p>

<p>janë të njëjtë, KQZ-ja mund të përfshijë informata për të bërë dallimin e tyre dhe për t'i ikur ngatërrimit në fletëvotim.</p> <p style="text-align: center;">Neni 51 Nënshkrimet</p> <p>51.1. Zyra për Regjistrimin e Partive i rishikon nënshkrimet e dorëzuara në mbështetje të aplikimit për certifikim sipas procesit të paraparë me rregull të KQZ-së, për të siguruar se nënshkrimet janë të vlefshme.</p> <p>51.2. Llojet e nënshkrimeve në vijim, janë të pavlefshme dhe nuk llogariten ndaj kërkesës së nënshkrimeve për certifikim:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) nënshkrimet e personave të cilët nuk janë votues të regjistruar; b) nënshkrimet e mbështetjes për të cilat çfarëdo informate e kërkuar mungon apo është e palexueshme; c) nënshkrimet të cilat janë me të njëjtin dorëshkrim si nënshkrimet tjera, përfshirë nënshkrimet nga udhëheqësi i familjes për anëtarët e tjerë të familjes; dhe d) nënshkrimet të cilat përfshijnë informata, të cilat nuk përputhen me informatat e regjistruara në LV-në më të përditësuar. 	<p>may include distinguishing information to avoid confusion on the ballot.</p> <p style="text-align: center;">Article 51 Signatures</p> <p>51.1. The Office of Political Party Registration shall review the signatures submitted in support of application for certification according to procedures set with the CEC rule, to ensure validity of the signatures.</p> <p>51.2. The following types of signatures shall be considered invalid and shall not count towards the signature requirement:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) signatures of persons who are not registered voters; b) signatures of support for which any required information is missing or illegible; c) signatures that are in the same handwriting as other signatures, including signatures by the head of the family for other family members; and d) signatures that include information that does not match information recorded in the most current version of the VL. 	<p>kandidata pod njegovim ili njenim zakonskim imenom. U slučaju da su imena ista, CIK može uključiti informacije kako bi se izvršilo njihovo razlikovanje i izbegla zabuna kod glasačkog listića.</p> <p style="text-align: center;">Član 51 Potpisi</p> <p>51.1. Kancelarija za registraciju političkih stranaka proverava podnete potpise u podršci aplikacije za sertifikaciju, prema procesu predviđenim pravilima CIK-a kako bi se osiguralo da su potpisi važeći.</p> <p>51.2. Vrste potpisa u nastavku su nevažeći i ne uzimaju se u obzir u odnosu na zahtev potpisa za sertifikaciju:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) potpisi lica koji nisu registrovani glasači; b) potpisi podrške za koje nedostaje ili je nečitka bilo koja tražena informacija; c) potpisi koji su istog rukopisa kao i drugi potpisi, uključujući potpise od strane starešine porodice za ostale članove porodice; i d) potpisi koji uključuju informacije koja se ne podudaraju sa registrovanim informacijama u ažuriranim GS.
---	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 52 Renditja e subjekteve politike në fletëvotim</p> <p>52.1. Shorti i fletëvotimit mbahet në një datë të caktuar nga KQZ-ja, për të vendosur renditjen e subjekteve politike të certifikuara në fletëvotim.</p> <p>52.2. Shorti bëhet sipas procedurave të përcaktuara nga rregullat e KQZ-së, duke siguruar se tërheqja është e drejtë dhe transparente. Kryesuesi i KQZ-së e kryeson tërheqjen e shortit.</p> <p>52.3. Zyra i njofton subjektet politike për vendndodhjen, datën, dhe kohën në të cilën shorti i fletëvotimit do të mbahet. Secili subjekt politik dërgon një përfaqësues për të tërhequr shortin dhe vëzhguar mbajtjen e shortit të fletëvotimit.</p> <p>52.4. Nëse subjekti politik nuk e dërgon përfaqësuesin në shortin e fletëvotimit, një anëtar i Sekretariatit e tërheqë shortin për atë subjekt.</p>	<p style="text-align: center;">Article 52 Political Parties Order of Ballot</p> <p>52.1. In order to establish the order of certified Political Parties on the ballot, a ballot lottery shall be held on a date determined by the CEC.</p> <p>52.2. The lottery shall be held in accordance with procedures defined by the CEC rule, ensuring that the lottery is fair and transparent. The Chairperson of the CEC shall preside over the drawing of lots.</p> <p>52.3. The Office shall notify the Political Entities of the location, date, and time at which the ballot lottery will be held. Each Political Entity may send a representative to draw a lot and observe the conduct of the ballot lottery.</p> <p>52.4. If a Political Entity does not send a representative to the ballot lottery, a member of the Secretariat shall draw a lot for that Entity.</p>	<p style="text-align: center;">Član 52. Redosled političkih subjekata u glasačkom listiću</p> <p>52.1. Izvlačenje žreba glasačkog listića održava se u danu određenom od CIK-a, kako bi se utvrdio redosled sertifikovanih političkih subjekata na glasačkom listiću.</p> <p>52.2. Izvlačenje žreba se vrši prema utvrđenim procedurama iz pravila CIK-a, osiguravajući da je izvlačenje pravedno i transparentno. Predsedavajući CIK-a predsedava izvlačenju žreba.</p> <p>52.3. Kancelarija obaveštava političke subjekte o mestu nalaženja, datumu i vremenu u kome će se žreb izvlačenja održati. Svaki politički subjekat šalje jednog predstavnika za izvlačenje žreba i posmatranje održavanja izvlačenja žreba glasačkog listića.</p> <p>52.4. Ukoliko politički subjekat ne šalje predstavnika na izvlačenje žreba glasačkog listića, jedan od članova Sekretarijata izvlači žreb za taj subjekat.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 53 Sanksionimi penal i subjekteve politike</p> <p>Sanksioni penal kundër subjektit politik të regjistruar do të thotë çregjistrim i atij subjekti politik, siç përcaktohet nga gjykata.</p>	<p style="text-align: center;">Article 53 Criminal conviction of political entities</p> <p>A criminal conviction against a registered political entity shall mean deregistration of that political entity, as determined by the court.</p>	<p style="text-align: center;">Član 53 Krivično sankcionisanje političkih subjekata</p> <p>Krivično sankcionisanje protiv registrovanog političkog subjekta znači ispisivanje takvog političkog subjekta, kako je utvrđeno od strane suda.</p>

<p align="center">KREU VII CERTIFIKIMI I KANDIDATËVE</p>	<p align="center">CHAPTER VII CANDIDATE CERTIFICATION</p>	<p align="center">VII POGLAVLJE SERTIFIKACIJA KANDIDATA</p>
<p align="center">Neni 54 Përshtatshmëria/aftësia e kandidatit</p> <p>54.1. Cilido person, emri i të cilit paraqitet në LV, është i aftë për certifikim si kandidat, përveç nëse ai apo ajo është:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) gjykatës apo prokuror në Kosovë ose gjetkë; b) pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës; c) pjesëtar i Policisë së Kosovës; d) pjesëtar i Shërbimit Doganor të Kosovës; e) pjesëtar i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë; f) kryesues i një agjencie të pavarur; g) përfaqësues diplomatik; h) kryesues apo anëtar i KQZ-së; i) pjesëtar i PZAP-it; j) anëtar i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve; k) pjesëtar i forcave të armatosura të ndonjë shteti; l) pjesëtar i ndonjë force policore apo të një trupi të ngjashëm; m) duke vuajtur dënimin e shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë; n) nën akuzë nga Tribunali dhe ka dështuar të veprojë në përputhje me urdhrin për t'u paraqitur para Tribunalit; o) dënuar me vendim gjyqësor të 	<p align="center">Article 54 Candidate Eligibility</p> <p>54.1. Any person whose name appears on the VL is eligible to be certified as a candidate, except if he or she is:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) judge or prosecutor in Kosovo or elsewhere; b) member of the Kosovo Security Force; c) member of the Kosovo Police; d) member of the Customs Service of Kosovo; e) member of the Kosovo Intelligence Agency; f) head of an independent agency; g) diplomatic representative; h) chairperson or a member of the CEC; i) member of the ECAC; j) member of a Municipal Election Commission; k) member of the armed forces of any state; l) member of any police force or similar body; m) serving a sentence imposed by the International Tribunal for the Former Yugoslavia; n) under indictment by the Tribunal and has failed to comply with an order to appear before the Tribunal; o) convicted for a crime by a final 	<p align="center">Član 54 Podobnost/Sposobnost kandidata</p> <p>54.10. Svako lice čije se ime pojavljuje na GS je sposobno za sertifikaciju kao kandidat, osim ukoliko je on ili ona:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) sudija ili tužilac na Kosovu ili drugde; b) pripadnik Bezbednosne snage Kosova; c) pripadnik Policije Kosova; d) pripadnik Carinske službe Kosova; e) pripadnik Kosovske obaveštajne agencije; f) predsedavajući nezavisne agencije; g) diplomatski predstavnik; h) predsedavajući ili član CIK-a; i) član IPŽP-a; j) član Opštinske izborne komisije; k) pripadnik oružanih snaga neke države; l) pripadnik snaga ili sličnog tela; m) na izdržavanje kazne izrečene od strane Međunarodnog Krivičnog Tribunala za bivšu Jugoslaviju; n) pod optužbom Tribunala i nije uspeo da deluje u skladu sa nalogom da se pojavljuje pred Tribunalom; o) kažnjen pravosnažnom sudskom presudom za krivično delo u zadnje tri godine; p) politički subjekat kome je oduzeto

<p>67.1. Asnjë subjekt politik, në asnjë rrethanë, nuk duhet të kalojë kufizimet në shpenzime dhe kontributet siç parashihet në dispozitat e këtij kreu.</p> <p>67.2. Asnjë subjekt politik nuk mund të shpenzojë më shumë se 0.5 EURO për votues të regjistruar, bazuar në numrin e përgjithshëm të votuesve të regjistruar në LV-në më të përditësuar.</p> <p>67.3. Shpenzimet maksimale për fushatë zbatohen për çdo mall dhe shërbim të shpenzuar për qëllime të fushatës, pa marrë parasysh kohën e blerjes apo të pajisjes me shërbime.</p> <p>67.4. Subjekti politik mund të pranojë kontribute, vetëm në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.</p> <p>67.5. Kontributet anonime janë të ndaluara.</p> <p>67. 6. Çështjet lidhur me financimin e fushatës zgjedhore që nuk i nënshtrohen këtij ligji, rregullohen në pajtueshmëri me Ligjin për financimin e subjekteve politike dhe Ligjin për parandalimin e shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit, dhe legjislacionin relevant.</p>	<p>67.1. No political entity, under no circumstances, shall break the spending and contribution limits as regulated by provisions of this Chapter.</p> <p>67.2. No political entity shall spend more than 0.5 EUR per registered, based on the general number of voters registered in the most current version of VL.</p> <p>67.3. Maximum campaign expenditures shall apply to any goods and services purchased for campaign purposes regardless of the time of purchase or provision of service.</p> <p>67.4. A political entity may accept contributions only in compliance to provisions of applicable legislation.</p> <p>67.5. Anonymous contributions shall be prohibited.</p> <p>67. 6. Matters concerning election campaign funding not subject to this law, shall be regulated in compliance with the Law on Financing Political Entities and the Law on Prevention of Money Laundering and Financing of Terrorism, and other relevant legislation.</p>	<p>67.1. Nijedan politički subjekat ni pod kojim okolnostima ne treba da prevazilazi ograničenja u troškovima i doprinosima, kao što je propisano odredbama ovog poglavlja.</p> <p>67.2. Nijedan politički subjekt ne može da troši više od 0.5 evra po registrovanom biraču, bazirajući se na ukupan broj registrovanih birača na ažuriranom BM.</p> <p>67.3. Maksimalni troškovi za kampanju primenjuju se za svaku robu ili uslugu, potrošenu za ciljeve kampanje, bez obzira na vreme nabavke ili opremanja uslugama.</p> <p>67.4. Politički subjekat može primiti doprinose, samo u skladu sa odredbama važećeg zakonodavstva.</p> <p>67.5. Anonimni doprinosi su zabranjeni.</p> <p>67.6. Pitanja u vezi sa finansiranjem izborne kampanje koja ne podležu ovom zakonu, regulišu se u skladu sa Zakonom o finansiranju političkih subjekata i Zakonom za sprečavanje pranja novca i finansiranje terorizma, kao i relevantnog zakonodavstva.</p>

<p align="center">Neni 68 Kërkesat për deklarim financiar</p>	<p align="center">Article 68 Financial Disclosure Requirements</p>	<p align="center">Član 68 Zahtevi za finansijsko izveštavanje</p>
<p>68.1. Informata rreth të gjitha shpenzimeve të bëra për fushatën zgjedhore duhet të përfshihen në Raportin për Deklarimin Financiar të Fushatës dhe të dorëzohet në KQZ, jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë pas ditës së zgjedhjeve dhe nëse zgjedhjet përsëritën, 30 (tridhjetë) ditë pas ditës së zgjedhjeve të përsëritura. Ky raport duhet po ashtu të përfshijë shpenzimet e të gjitha degëve dhe pjesëve tjera përbërëse të subjekteve politike.</p> <p>68.2. Tri (3) ditë pas marrjes së donacionit, një subjekt politik ose përfaqësuesi i tyre duhet të publikojë informatën rreth marrjes së donacionit në ueb-faqen e tyre zyrtare, në një portal të dizajnuar vetëm për këtë qëllim. Këto të dhëna do të përfshijnë datën e marrjes së donacionit, shumën, emrin dhe mbiemrin e donatorit. Këto të dhëna duhet të jenë të hapura për publikun.</p> <p>68. 3. Secili raport i publikimit financiar të fushatës, i secilit subjekt politik, duke i përfshirë të gjitha degët e tyre dhe pjesët përbërëse, përfshinë publikimin komplet dhe të saktë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) të ardhurave të subjektit politik për periudhën raportuese, përfshirë burimin dhe datën e të gjitha kontributeve me para të gatshme; b) të gjitha shpenzimet, përfshirë shpenzimet e fushatës, të bëra nga subjekti gjatë periudhës raportuese; dhe 	<p>68.1. Information on election campaign expenditures shall be part of the Entity's Financial Disclosure Report which must be submitted to the CEC no later than forty-five(45) days from election day, and in case of repeat election, thirty (30) days after the repeated election. This report shall also include expenditures of all branches and other constituent parts of political entities.</p> <p>68. 2. Three (3) from receiving a donation, a political entity or its representative shall make public information on receiving the donation on their official website, at a portal designed solely for this purpose. Such information shall include the date the donation is received, the amount, name and surname of the donor. These information shall be accessible by the public.</p> <p>68. 3. Each Campaign Financial Disclosure Report of every political entity including all of their branches and constituent parts shall include complete and accurate disclosure of:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) the Income of the Political Entity during the reporting period, including the source and date of all cash Contributions; b) all Expenditures, including Campaign Expenditures, made by the Entity during the reporting period; and raportuese; dhe c) a balance sheet showing the Assets, Liabilities and Equity of the Entity as 	<p>68.1. Informacije o svim izvršenim troškovima za izbornu kampanju treba da budu uključene u Izveštaju o finansijskom izveštavanju kampanje i dostavljaju u CIK-u ne kasnije od četrdeset i pet (45) dana nakon dana izbora i ukoliko se izbori ponavljaju, trideset (30) dana nakon dana ponovljenih izbora. Ovaj izveštaj treba, takođe, da uključuje troškove svih ogranaka i drugih sastavnih delova političkih subjekata.</p> <p>68.2. Tri (3) dana nakon prijema donacije, jedan politički subjekat ili njihov predstavnik treba da objavljuje informaciju oko prijema donacije na njihovoj zvaničnoj veb – stranici, u jednom portalu, dizajniranim samo za ovu namenu. Ovi podaci će uključiti datum prijema donacije, iznos, ime i prezime donatora. Ovi podaci moraju biti otvoreni za javnost.</p> <p>68.3. Svaki izveštaj finansijskog izveštavanja kampanje, svakog političkog subjekta, uključujući sve njihove ogranke i sastavne delove, uključuje kompletno i tačno objavljivanje:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) prihoda političkog subjekta za izveštajni period, uključujući izvor i datum svih doprinosa u gotovom novcu; b) sve troškove, uključujući troškove kampanje, izvršene od strane subjekta tokom izveštajnog perioda; c) bilansni list koji predstavlja imovinu, obaveze i sravnjivanje subjekta od prvog

<p>c) një fletë bilanci që i paraqet pasuritë, detyrimet dhe barazimin e subjektit prej ditës së parë, deri te dita e fundit e periudhës së raportimit.</p> <p>68. 4. Subjektet politike i dorëzojnë në Zyrë kopjet e dëftesave për secilën pagesë administrative të paguar.</p> <p>68.5. Zyra i raporton KQZ-së për secilën pagesë administrative të mbledhur dhe të transferuar në Buxhetin e Kosovës.</p> <p>68. 6. Nëse një subjekt politik nuk e dorëzon Raportin e publikimit financiar të fushatës deri në afatin përfundimtar ose, nëse e dorëzon raport jo të plotë ose të pasaktë, Zyra mund t'ia paraqesë ankesën PZAP-it, në pajtim me procedurat e atij organi.</p> <p>68.7. Secili subjekt politik i certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje i mban dhe ruan në arkivat e tyre, për një periudhë 7 (shtatë) vjeçare, shënimet e sakta dhe të detajuara të gjendjes financiare të subjektit dhe të gjitha degëve për periudhën e mbuluar me raportet e publikimit financiar të fushatës, përfshirë:</p> <p>a) librat e mbajtjes së llogarive me shënime, në pajtueshmëri me parimet e kontabiliteti;</p> <p>(i) të gjitha të ardhurat sipas burimit, shumës, duke e identifikuar mënyrën se si është kryer pagesa (d.m.th., para të gatshme, çek, draft bankier, etj.); dhe</p> <p>(ii) të gjitha pagesat, të cilat i ka kryer subjekti ndaj personit tjetër,</p>	<p>of the first and last day of the reporting period.</p> <p>68. 4. Political entities shall provide the Office with copies of receipts for each administrative fee paid.</p> <p>68.5. The Office shall report to the CEC on all administrative fees collected and remitted hereunder to the Kosovo Budget.</p> <p>68. 6. If a Political Entity fails to submit a Campaign Financial Disclosure Form by the deadline, or if it submits an incomplete or inaccurate report, the Office may file a complaint with the ECAC in accordance with the procedures of that body.</p> <p>68.7. Each Political Entity certified to participate in an election shall keep and maintain for a period of seven (7) years accurate and detailed records of the financial situation of the Entity and all of its branches during the period covered by the Campaign Financial Disclosure Reports, including:</p> <p>a) accounting books that record, in accordance with generally accepted accounting principles:</p> <p>(i) all Income by source, amount, identifying the manner in which the Payment was made (i.e. cash, cheque, bank draft, etc.); and</p> <p>(ii) all Payments made by the Entity to another person, the purpose of the Payment and the manner in which the Payment was made;</p> <p>b) receipts for all Expenditures in excess of one hundred euro (€100);</p>	<p>dana do zadnjeg dana perioda izveštavanja.</p> <p>68.4. Politički subjekti dostavljaju u Kancelariji kopije računa za svaku naplaćenu administrativnu isplatu.</p> <p>68.5. Kancelarija izveštava CIK- za svaku ubranu i transferisanu administrativnu uplatu u budžet Kosova.</p> <p>68.6. Ukoliko jedan politički subjekat ne dostavlja Izveštaj o finansijskom izveštavanju kampanje do konačnog roka, ili, ukoliko dostavlja nepotpun i netačan izveštaj, Kancelarija može uložiti žalbu IPŽP-u u skladu sa procedurama tog organa.</p> <p>68.7. Svaki sertifikovani politički subjekat za učešće na izborima vodi i čuva u svojim arhivama, za period od sedam (7) godina, tačne i detaljne podatke finansijskog stanja subjekta i svih ogranaka za pokriveni period sa Izveštajima o finansijskom objavljivanju kampanje, uključujući:</p> <p>a) knjige računovodstva sa podacima, u skladu sa principima računovodstva.</p> <p>(i) sav prihod prema izvoru, iznosu, identifikujući način na koji je izvršena isplata (tj., u gotovom novcu, čekom, bankarskim draftom i dr.); i</p> <p>(ii) sve isplate koje je izvršio subjekat prema drugom licu, svrha isplate i način kako je isplata izvršena;</p> <p>b) potvrde za sve troškove koji premašuju iznos od stotinu (100) €;</p> <p>c) bankarske podatke svih računa koje vodi politički subjekat ili koji su na njegovo ime;</p> <p>d) dokumenta koja grade pravni osnov za</p>
--	---	--

<p>qëllimi i pagesës dhe mënyra se si është kryer pagesa;</p> <p>b) dëftesat për të gjitha shpenzimet që tejkalojnë shumën prej 100 (njëqind) euro;</p> <p>c) shënimet bankare për të gjitha llogaritë të cilat i mban subjekti politik ose që janë në emër të tij;</p> <p>d) dokumentet të cilat e ndërtojnë bazën ligjore për pronësi ose posedim të tërë pasurisë së patundshme të subjektit politik;</p> <p>e) kontratat, partner i të cilave është subjekti, përfshirë kontratat lidhur me qiranë ose blerjen e pasurisë së tundshme apo të patundshme;</p> <p>f) një regjistrim i të gjitha kontributeve të subjektit, pa marrë parasysh se kur janë bërë, përfshirë:</p> <p>(i) vlerën e secilit kontribut;</p> <p>(ii) datën kur është dhënë secili kontribut;</p> <p>(iii) emrin e plotë, adresën dhe regjistrimin civil, numrin e pasaportës ose të lejes së vozitjes të secilit kontribuues; dhe</p> <p>(iv) emrin e plotë të personit, i cili e ka pranuar kontributin në emër të subjektit.</p> <p>68.8. KQZ-ja organizon trajnime për zyrtarët financiarë të subjekteve politike.</p>	<p>c) bank records for all accounts held by or on behalf of the Political Entity;</p> <p>d) documents establishing the legal basis for ownership or occupation of all real property occupied by the Political Entity;</p> <p>e) contracts to which the Entity is a party, including contracts relating to the lease or purchase of movable or immovable property;</p> <p>f) a record of all Contributions to the Entity, regardless of when they were made, including:</p> <p>(i) the value of each Contribution;</p> <p>(ii) the date on which each Contribution was made;</p> <p>(iii) the full name, address and Civil Registration, passport or driver's license number of each contributor; and</p> <p>(iv) the full name of the person who received the Contribution on behalf of the Entity.</p> <p>68.8. The CEC shall organize training for financial officers of Political Entities.</p>	<p>vlasništvo ili posedovanje celokupne nepokretne imovine političkog subjekta;</p> <p>e) ugovore, čiji je partner subjekat, uključujući ugovore u vezi kirije ili nabavke pokretne ili nepokretne imovine;</p> <p>f) registraciju svih doprinosa subjekta, bez obzira kada su izvršeni, uključujući:</p> <p>(i) vrednost svakog doprinosa;</p> <p>(ii) dan kada je svaki doprinos dat;</p> <p>(iii) puno ime, adresu i Civilni registar, broj pasoša ili vozačke dozvole svakog doprinosioca; i</p> <p>(iv) puno ime lica koje je primio doprinos u ime subjekta.</p> <p>68.8. CIK organizuje obuku za finansijske službenike političkih subjekata.</p>
---	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 69 Auditimi</p> <p>Auditimet bëhen konform dispozitave të Ligjit për për financimin e subjekteve politike.</p>	<p style="text-align: center;">Article 69 Auditing</p> <p>Auditing shall be conducted in compliance with the Law on Financing Political Entities.</p>	<p style="text-align: center;">Član 69 Revizija</p> <p>Revizija se vrši u skladu sa odredbama Zakona o finansiranju političkih subjekata.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 70 Sanksionet</p> <p>Sanksionimi bëhet konform dispozitave të Ligjit për për financimin e subjekteve politike.</p>	<p style="text-align: center;">Article 70 Sanctions</p> <p>Sanctions shall be applied in compliance with the Law on Financing Political Entities.</p>	<p style="text-align: center;">Član 70 Sankcije</p> <p>Sankcije se primenjuju u skladu sa odredbama Zakona o finansiranju političkih subjekata.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 71 Informimi publik</p> <p>KQZ-ja, në bazë të Ligjit për financimin e subjekteve politike, publikon raportin e Auditorit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 71 Public Information</p> <p>CEC shall publish the Auditor's report, based on the Law on Financing Political Entities.</p>	<p style="text-align: center;">Član 71 Javno informisanje</p> <p>Shodno Zakonu o finansiranju političkih subjekata, CIK objavljuje izveštaj o izvršenoj reviziji.</p>
<p style="text-align: center;">KREU X FUSHATA E ZGJEDHJEVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 72 Dispozitat e përgjithshme</p> <p>72. 1. Mënyrat për të bërë fushatë përfshijnë tubime me publikun, posterët, media dhe internetin. Gjatë fushatës, autoritetet dhe të gjitha subjektet politike duhet të respektojnë të drejtat themelore, siç janë paraparë me Kushtetutë dhe ligjeve tjera në fuqi. Fushata zgjat 15 ditë.</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER X ELECTION OBSERVERS</p> <p style="text-align: center;">Article 72 General Provisions</p> <p>72. 1. Campaigns may be run including meeting with the public, posters, media and the Internet. During the campaign, the authorities and all political entities shall respect basic rights in accordance with the Constitution and other applicable laws. The Campaign shall be 15 days.</p>	<p style="text-align: center;">POGLAVLJE X IZBORNA KAMPANJA</p> <p style="text-align: center;">Član 72 Opšte Odredbe</p> <p>72.1. Izborna kampanja obuhvata skupove sa publikom, postere, medije i internet. U toku izborne kampanje, organi i svi politički subjekti moraju poštovati ustavom i važećim zakonima predviđene osnovne slobode. Izborna kampanja traje 15 dana.</p>

<p>72.2. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, subjektet politike kanë të drejtë të ndërmarrin aktivitete politike të fushatës, në këto mënyra:</p> <p>a) të organizojnë dhe mbajnë tubime/ngjarje politike, tryeza të rrumbullakëta, konferenca për shtyp, fjalime, ose ndonjë aktivitet tjetër të ngjashëm, përmes të cilave ata mund t'i shprehin lirisht mendimet e tyre me qëllim të fitimit të përkrahjes nga votuesit e tyre;</p> <p>b) të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore; dhe</p> <p>c) të bëjnë fushatë përmes cilitdo operator televiziv, të radios apo kabllor, gjithashtu edhe përmes revistave, shtypit, rrjetit telefonik, sistemit postar ose çdo lloj mjeti tjetër reklamues, në pajtim me rregullat e KQZ-së dhe ligjet tjera në fuqi.</p> <p>72.3. Subjektet politike dhe kandidatët e tyre, nuk mund të ndërmarrin aktivitete të fushatës zgjedhore, sikur në nenin 72.2, nga data e shpalljes së zgjedhjeve, deri në fillimin e fushatës zyrtare.</p> <p>72.4. Aktivitetet të cilat janë të menduara vetëm për nominimin e një kandidati të një subjekti politik, përfshirë mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme për qëllime të nominimit, dhe të cilat janë bërë pa shpallje publike, nuk konsiderohen aktivitete politike të para-fushatës.</p> <p>72.5. Subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre, apo ndonjë individ</p>	<p>72.2. During the election campaign period, Political Entities shall have the right to conduct political activities of the election as follows:</p> <p>a) organize and hold public meetings/events, round-tables, press conferences, speeches, or any other similar activities, at which they can freely express their opinions in order to gain support from voters;</p> <p>b) publish and distribute placards, posters and other material related to an election campaign; and</p> <p>c) conduct the campaign through any of the television, radio or cable television, as well as magazines, publishing, telephone, postal system or any other means of advertising, in concordance with CEC rules and other applicable laws.</p> <p>72.3. Political Entities and their candidates may not conduct activities relating to election campaign as provided under Article 72.2 from the date of announcement of elections up to the official commencement of the campaign.</p> <p>72.4. Activities intended for nomination of a candidate of a political entity, including collection of required signatures for the purpose of nomination, conducted without public announcements, shall not be considered as a pre-election political activity.</p> <p>72.5. Political entities, candidates and their supporters or other individuals shall not involve children in conducting political</p>	<p>72.2. U periodu izborne kampanje, politički subjekti imaju pravo preduzeti sledeće kampanjske političke aktivnosti, i to:</p> <p>a) organizuju i održavaju javne političke i sastanke/događaje, okrugle stolove, konferencije za štampu, govorcije ili druge slične aktivnosti na kojima oni, radi pridobijanja podrške njihovih birača, mogu slobodno izražavati njihova mišljenja;</p> <p>b) Objavljuju i rasturaju plakate, postere i drugi izborni reklamni materijal o izbranoj kampanji, i</p> <p>c) Obavljaju kampanju preko bilo kojeg radija, kao i satelitske i kablovske TV-je, te preko novina novina, štampe, telefonske mreže, poštanskog sistema, ili bilo kojim drugim reklamnim sredstvima, u skladu sa Pravilima CIK i drugim važećim zakonima.</p> <p>72.3. Politički subjekti i njihovi kandidati, od dana objavljivanja izbora, do početka zvanične kampanje ne smeju preduzeti aktivnosti izborne kampanje kao u članu 72.2.</p> <p>72.4. Aktivnosti koje se isključivo tiču imenovanju jednog kandidata političkog subjekta, uključujući prikupljanje potpisa, potrebnih za naimenovanje, a koje se odvijaju bez javnog oglasa, ne smatraju se političkim predizbornim aktivnostima.</p>
--	---	--

<p>tjetër, nuk duhet të përfshijnë fëmijët në ndonjë aktivitet politik të fushatës.</p> <p>72.6. Subjektet politike, kandidatët dhe individët, nuk mund të ndërmarrin aktivitete të fushatës zgjedhore gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore siç është përkufizuar në nenin 3 të këtij ligji.</p> <p>72.7. Pas përfundimit të votimit, përfundon periudha e heshtjes zgjedhore.</p> <p>72.8. Fushata zgjedhore organizohet në atë mënyrë që një atmosferë e pëlqyeshme dhe paqësore të mbizotërojë gjatë fushatës zgjedhore.</p>	<p>activity during the campaign.</p> <p>72.6. Political entities, candidate and individuals shall not conduct electoral campaign during the electoral silence period as defined in Article 3 of this law.</p> <p>72.7. The election silence period shall end after voting is completed.</p> <p>72.8. Election campaigns shall be organized in such manner that a congenial and peaceful atmosphere prevails during the campaign period.</p>	<p>72.5. Politički subjekt, kandidati i njihove pristalice ili bilo koji drugi pojedinac ne smeju uključiti decu u bilo koju političku aktivnost izborne kampanje.</p> <p>72.6. Shodno članu 3 ovog Zakona, u periodu izborne čutnje, politički subjekt, kandidati i pojedinci, ne smeju obavljati nikakve aktivnosti izborne kampanje.</p> <p>72.7. Po završetku glasanja, prestaje izborna čutnja.</p> <p>72.8. Izborna kampanja organizuje se tako da u njoj vlada ugodna i mirna atmosfera koja mora trajati čitavo vreme izborne kampanje.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 73 Përgjegjësitë e subjekteve politike, mbështetësve të tyre dhe kandidatëve</p>	<p style="text-align: center;">Article 73 The Responsibilities of Political Entities, their Supporters and Candidates</p>	<p style="text-align: center;">Član 73 Odgovornosti političkih subjekata, njihovih pristalica i kandidata</p>
<p>73.1. Subjektet politike informojnë në mënyrë të duhur anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre rreth dispozitave të këtij ligji.</p> <p>73.2. Subjektet politike ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të parandaluar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre nga shkelja e këtij ligji.</p> <p>73. 3. Subjektet politike dhe kandidatët duhet:</p> <p style="padding-left: 20px;">a) të sigurojnë që të gjitha materialet e fushatës të vendosura në vendet publike, duke përfshirë posterët, të</p>	<p>73.1. Political Entities shall effectively inform their members, supporters and candidates of the provisions of this law..</p> <p>73.2. Political Entities shall make all reasonable efforts to prevent their members, supporters and candidates from violating this law.</p> <p>73. 3. Political Entities and candidates shall:</p> <p style="padding-left: 20px;">a) ensure that all campaign materials placed on public spaces, including posters, are removed within ten (10) days of certification of election results.</p>	<p>73.1. Politički subjekt informišu njihove članove pristalice i kandidate, na odevkvan način o odredbama ovog Zakona.</p> <p>73.2. Politički subjekt moraju preduzeti sve neophodne mere kako njihovi članovi, pristalice i kandidati ne bi kršili ovaj Zakon.</p> <p>73.3. Politički subjekt i kandidati moraju:</p>

<p>hiqen brenda 10 (dhjetë) ditëve pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve. Secili subjekt politik duhet të emërojë një zyrtar përgjegjës të fushatës brenda 3 (tri) ditëve pas certifikimit nga KQZ, i cili do të jetë përgjegjës për të zbatuar këtë dispozitë. Emri dhe informatat kontaktuese duhet të dorëzohen në KQZ dhe PZAP, pas dorëzimit të listës së kandidatëve dhe certifikimit nga KQZ.</p> <p>b) Të gjitha subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilitdo VV ose QV në rreze prej 100 metrash, çfarëdo materiali i tillë i mbetur 24 orë para fillimit të votimit, duhet të largohet nga anëtarët e KVV-ve ose menaxheri i QV-së. Subjektet politike të cilat nuk kanë larguar dhe/ose janë gjetur duke postuar material të fushatës zgjedhore pas afatit kohor të vendosur, duhet të raportohen në PZAP për shkelje të këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 74 Ndalimi i përdorimit të mirave publike dhe dhënia e ndihmës nga shërbyesit civilë</p> <p>74.1. Asnjë person nuk do të ofrojë apo pranojë beneficione të një resursi në pronësi, zotim apo përdorim nga ana e administratës publike të nivelit qendror</p>	<p>Each political entity shall appoint a campaign official within three (3) days of the certification of results by the CEC who shall be responsible for implementation of this provision. Name and contact information shall be submitted to the CEC and ECAC, after the submission of candidate list and CEC certification.</p> <p>b) All political entities which have not removed their election campaign materials placed inside and within a radius of 100 meters of a PS or PC, or any other material, 24 hours prior to commencement of polling shall have such material removed by the PSC members or the PC Manager. Political entities which have not removed and or were found posting election campaign material after the imposed deadline shall be reported to the ECAC for violating this Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 74 Prohibition of use of public goods and support by the Civil Servants</p> <p>74.1. Nobody shall offer or receive benefits from a resource owned, in possession or in use by the local and central level public administration or</p>	<p>a) Obezbediti da se svi materijali izborne kampanje postavljeni na javnim mestima, uključujući i postere, uklone u roku od deset (10) dana, od dana sertifikacije izbornih rezultata. Svaki politički subjekat mora naimenovati jednog odgovornog službenika kampanje u roku od tri (3) dana, nakon sertifikacije od strane CIK-a, koji će biti odgovoran za sprovođenje ove odredbe. Ime i kontaktne informacije moraju se dostaviti CIK-u i IPPŽ, nakon predaje lista kandidata i sertifikacije od strane CIK-a.</p> <p>b) Svi politički subjekti koji nisu uklonili njihove materijale izborne kampanje postavljene unutar i u radijusu od 100 metara oko BM ili BC, i svaki takav materijal koji je ostao dvadeset četiti (24) sata pre početka glasanja, mora se ukloniti od strane članova KBM ili menadžera BC. Politički subjekti koji nisu uklonili i/ili se zateknu postavljajući materijal izborne kampanje nakon isteka predviđenog vremenskog roka, treba prijaviti IPŽP-u zbog kršenja ovog Zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 74 Zabrana korišćenja javnih resursa i pružanja pomoći civilnih službenika</p> <p>74.1. Nijedno lice ne sme pružiti ili primiti beneficije nekog resursa u vlasništvu, u korišćenju ili u posedu javne administracije centralnog ili lokalnog</p>
--	--	--

<p>apo lokal, apo nga cilado ndërmarrje në pronësi apo në kontrollin e administratës publike që kjo të përdoret apo të shfrytëzohet në mbështetje të një kandidati garues në zgjedhje.</p> <p>74.2. Asnjë person që mban një funksion publik, si i zgjedhur apo i emëruar, nuk mund të përdorë zyrën apo ndonjë resurs publik me qëllim të fitimit të votave apo të mbështetjes së një kandidati garues në zgjedhje, përveç Presidentit, Kryeministrit dhe Kryetarit të Kuvendit, të cilët i përdorin resurset publike për siguri personale.</p> <p>74.3. Asnjë kandidat apo mbështetës nuk do të kërkojë ose pranojë ndihmë nga një punonjës publik për të përdorur pozitën e tij apo të saj publike, apo të ndonjë resursi të cekur në paragrafin 1 të këtij neni, në mbështetje të fushatës së një kandidati garues në zgjedhje.</p> <p>74.4. Pavarësisht nga paragrafët paraprakë, subjektet politike të certifikuara dhe kandidatët mund të përdorin objektet dhe pajisjet e institucioneve publike për takime publike, duke iu nënshtruar këtyre obligimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) sigurimin e qasjes së barabartë për të gjitha subjektet politike të certifikuara dhe kandidatët; b) mospengimin e aktiviteteve të rregullta të institucionit përkatës; dhe c) paraqitjen paraprake të kërkesës tek personi përgjegjës për institucionin. Dhënia e lejes për shfrytëzimin e objektit duhet të jepet nga personi 	<p>business outlet or from any enterprise owned or controlled by the public administration to be used or utilized to support a candidate in election contest.</p> <p>74.2. No person exercising a public function , whether elected or by appointment, shall use his/her office or any other public resource to gain votes or to support a candidate in election, excluding the President, the Prime Minister and the President of the Assembly who use public resources for personal protection.</p> <p>74.3. No candidate or supporter shall request for or accept support from a public worker to use his or her public position or a resource referred to in paragraph 1 of this article, to support the campaign of a candidate in election contest.</p> <p>74.4. Notwithstanding previous paragraphs, certified political entities and candidates may use public premises and equipment for public meetings, by observing the following obligations:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) ensuring equal access for all certified political entities and candidates; b) without disrupting regular activities of the the institution; and c) submitting in advance the request to the responsible person in the institution. A permission to use the premises shall be issued by the responsible person of the institution, except cases where conditions under a) and b) are not met. 	<p>nivou ili bilo kog preduzeća u vlasništvu ili pod kontrolom javne administracije niti koristi to za podršku nekog kandidata koji učestvuje na izborima.</p> <p>74.2. Nijedno lice koje je nosilac javne funkcije, kao biran ili imenovan ne sme koristi kancelariju ili javne resurse u cilju dobijanja glasova ili podrške nekom kandidatu koji se takmiči na izborima, osim predsednika, premijera ili predsednika Skupštine, koji koriste javne resurse za ličnu bezbednost.</p> <p>74.3. Nijedan kandidat ili pristalica ne sme tražiti ili primiti pomoć od javnog radnika u cilju korišćenja njegovog/njenog javnog položaja ili resursa iz stava 1 ovog člana, u cilju podrške kampanje nekog kandidata koji se takmiči na izborima.</p> <p>74.4. Bez obzira na prethodne stavove, sertifikovani politički subjekti i kandidati mogu koristiti prostorije i opremu javnih institucija za javne skupove, pridržavajući se sledećim obavezama:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Obezbeđivanje jednakog pristupa svim sertifikovanim političkim subjektima i kandidatima; b) Obezbeđivanje nesmetanih redovnih aktivnosti dotične institucije; i c) Prethodno podnošenje zahteva odgovornom licu institucije. Dozvolu za korišćenje objekata izdaje odgovorno lice
--	--	---

<p>përgjegjës i institucionit, përveç nëse nuk janë përmbushur kushtet nën a) ose b).</p> <p style="text-align: center;">Neni 75 Veprimet e Ndaluar nga Subjektet Politike</p> <p>75.1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:</p> <p>a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posterit ose materiali tjetër, i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;</p> <p>b) vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda apo në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve;</p> <p>c) mbajtja ose ekspozimi i armëve të secilit lloj gjatë tubimeve politike ose gjatë çfarëdo lloj ngjarjeje që ka lidhje me aktivitetet e subjekteve politike. Mbajtja e armëve nga personat e tjerë</p>	<p style="text-align: center;">Article 75 Prohibited Actions by Political Entities</p> <p>75.1. During the campaigning period a Political Entity, its supporters or candidates shall be prohibited from doing any of the following:</p> <p>a) removing, covering, destroying, or altering any printed notice, placard, poster or other material, which is used for the purpose of election campaigning by another Political Entity;</p> <p>b) displaying notices, placards and posters, or otherwise placing their names or slogans related to the election campaign, in or on public buildings or structures, on or above public roads, on public road traffic signs, in or on premises or structures occupied or otherwise used by international organizations, or in private premises without permission of the owners or users;</p> <p>c) carrying or displaying weapons of any kind at political meetings or during any events related to the activities of Political Entities. Carrying of weapons by other persons during political meetings/celebrations shall be</p>	<p>institucije, sem u slučaju kada nisu ispunjeni uslovi iz tačke a) ili b).</p> <p style="text-align: center;">Član 75 Zabranjene radnje političkih subjekata</p> <p>75.1. U periodu izborne kampanje, političkom subjektu, njegovom kandidatu ili pristalici, zabranjuju se sledeće radnje:</p> <p>a) Uklanjanje, skrivanje, uništavanje ili izmena nekog oglasa, plakata, postera, ili drugog materijala kojog drugi politički subjekt koristi za izbornu kampanju;</p> <p>b) Postavljanje oglasa, plakata i postera, ili postavljanje njihovih imena ili slogana koji se tiču izborne kampanje, unutar ili van javnih objektata ili prostora, na ili nad javnim putevima, na javnim saobraćajnim znacima, unutar ili van zauzetih prostorija ili zgrada koje koriste međunarodne organizacije, ili u na privatnim prostorijama bez dozvole vlasnika ili korisnika;</p> <p>c) Nošenje ili izloženje oružja bilo koje vrste za vreme političkih skupova ili bilo kojeg događaja vezanog za aktivnost političkih subjekata. Nošenje oružja od strane drugih lica za vreme političkih manifestacija i skupova, dozvoljeno je</p>
---	---	--

<p>gjatë tubimeve politike/manifestimeve lejohet vetëm në rast se personat që mbajnë armë është njoftuar paraprakisht se të tilla armë do të mbahen në tubimet e caktuara;</p> <p>d) çrregullimi i tubimeve të subjekteve tjera politike ose nxitja e të tjerëve për një veprim të tillë;</p> <p>e) pengimi ose tentimi për pengimin e gazetarëve për të përmbushur detyrat e tyre profesionale;</p> <p>f) premtimi dhe dhënia e ndonjë shpërblimi financiar, me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve;</p> <p>g) kërcënimi ose tentimi për të kërcënuar subjektet tjera politike, përkrahësit ose kandidatët e tyre;</p> <p>h) nxitja e cilitdo person për të votuar në zgjedhje, i cili nuk ka të drejtë vote;</p> <p>i) nxitja e personit për të votuar më shumë se një herë në të njëjtat zgjedhje ose të votojë në emër të një personi tjetër;</p> <p>j) abuzimi me të drejtën e ankesës ose duke bërë ankesa ose paraqitje të rrejshme, të pavlera dhe irrituese në PZAP;</p> <p>k) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj</p>	<p>permitted only when persons carrying weapons notified in advance that such weapons shall be carried during certain meetings;</p> <p>d) disturbing meetings of other Political Entities or inciting others to do so;</p> <p>e) preventing or attempting to prevent journalists from carrying out their professional functions;</p> <p>f) promising any financial reward for the purpose of gaining support of voters;</p> <p>g) threatening, or attempting to threaten, other Political Entities or their supporters or candidates;</p> <p>h) encouraging any person to vote in an election who has no legal right to vote;</p> <p>i) encouraging a person to vote more than once in the same election, or to vote in the name of another person;</p> <p>j) abusing the right to complain, or making false, frivolous or vexatious complaints or submissions to the ECAC;</p> <p>k) using language, in oral or written form, which incites or provokes, or is likely to incite or provoke, another person to commit an act of violence against other persons or property, or which incites or is likely to incite hatred towards others, or publishing or using pictures, symbols or any other material that has or is likely to have such effects;</p> <p>l) for the purpose of promoting a</p>	<p>samo ako je prethodno prijavljena da će ta lica, u određene skupove, nositi tu vrstu oružja;</p> <p>d) Ometanje skupova drugih političkih subjekata ili podsticanje drugih na takav čin;</p> <p>e) Ometanje ili pokušaj ometanja novinara na obavljanju njihove profesionalne dužnosti;</p> <p>f) Obećavanje ili davanje neke novčane nagrade u cilju pridobijanja podrške glasača;</p> <p>g) Pretnja ili pokušaj pretnje drugim političkim subjektima, njihovim pristalicama ili kandidatima;</p> <p>h) Podsticanje bilo koga, koji nema pravo glasa, na glasanje;</p> <p>i) Podsticanje bilo koga da glasa više od jedan put na istim izborima, ili da glasa u ime nekog drugog lica;</p> <p>j) Zloupotrebljavanje prava žalbe, ili podnošenje lažne žalbe ili predstavke IPŽP;</p> <p>k) Korišćenje jezika mržnje u pismenoj ili usmenoformi, koji vređa ili provocira, ili može izazvati ili isprovocirati drugoga na akt nasilja protiv drugih lica ili imovine, ili koji može izazvati ili izaziva mržnju</p>
---	--	--

<p>materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë;</p> <p>l) për qëllime të promovimit të subjektit politik ose kandidatëve të tij, duke përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali i cili i referohet personit, i cili:</p> <p>(i) është në vuajtje të dënimit të shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë; ose</p> <p>(ii) ka padi të ngritur nga Tribunali dhe i cili nuk i është përmbajtur urdhrit për t'u paraqitur para Tribunalit.</p> <p>m) përdorim ose kërcënim të përdorimit të dhunës në çfarëdo mënyre; ose</p> <p>n) nxitjen, mbështetjen apo aprovimin e përdorimit të dhunës, kërcënimit apo frikësimit, gjatë procesit zgjedhor.</p>	<p>Political Entity or its candidates using pictures, symbols or any other material which refers to a person who:</p> <p>(i) serving a sentence imposed by the International Tribunal for the Former Yugoslavia;</p> <p>(ii) is under indictment by the Tribunal and has failed to comply with an order to appear before the Tribunal.</p> <p>m) the use or threat of use of violence of any kind; or</p> <p>n) inciting, supporting or endorsing the use of violence, threat or intimidation during the electoral process.</p>	<p>prema drugima, ili objavljivanjem ili korišćenjem slika, simbola ili drugog materijala koji može imati ili ima takave efekte;</p> <p>l) U cilju promocije političkog subjekta ili njegovih kandidata koristeći slike, simbole ili neki drugi materijal koji se odnosi na:</p> <p>(i) Osobu koja je na održavanju kazne zatvora, izrečene od Međunarodnog krivičnog suda za bivšu Jugoslaviju; ili</p> <p>(ii) Osobu koja je pod optužnicom Tribunala i nije se pridržavao nalogu da se prijavi pred Tribunalom.</p> <p>m) Upotrebu ili pretnju upotrebom nasilja bilo koje vrste, ili</p> <p>n) Podsticanje, podržavanje ili odobravanje upotrebe nasilja, pretnje nasiljem ili zastrašivanja u toku izbornog procesa.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 76</p> <p style="text-align: center;">Pjesëtarët e Armatosur të Njësisë për Mbrojtje të Afërt në tubimet politike</p> <p>Pjesëtarët e Njësisë për mbrojtje të afërt, të cilët janë në detyrë në tubime elektorale, mbajnë armë sipas autorizimeve të dhëna nga autoritetet përgjegjëse për zbatimin e ligjit. Para çdo tubimi elektorale pjesëtarët e mbrojtjes së afërt identifikohen paraprakisht dhe sipas kërkesës së zyrtarit policor të Kosovës. Të gjitha armët e</p>	<p style="text-align: center;">Article 76</p> <p style="text-align: center;">Armed Close Protection Staff at Political Events</p> <p>Armed close protection unit members who are on duty at any election event shall carry weapons as authorized by the appropriate law implementing authorities. Close protection unit members shall identify themselves beforehand and upon request to any Kosovo Police Officer. All arms carried by the close protection unit</p>	<p style="text-align: center;">Član 76</p> <p style="text-align: center;">Naoružani pripadnici Jedinice za blisku zaštitu na političkim skupovima</p> <p>Članovi jedinice bliske zaštite koji su na dužnosti prilikom izbornih skupova, mogu nositi oružje na osnovu vlašćenja nadležnih organa za provedbu zakona. Pre svakog izbornog skupa, takve osobe bliske zaštite se prethodno identifikuju na zahtev policijskog sužbenika KP-a. Sve oružje pripadnika Jedinice za blisku zaštitu</p>

<p>pjesëtarëve për mbrojtje të afërt duhet të mbahen të mbuluara.</p> <p style="text-align: center;">KREU XI MEDIAT</p> <p style="text-align: center;">Neni 77 Dispozitat e përgjithshme</p> <p>77.1. Kodi i Sjelljes për mediat transmetuese dhe Kodi i Sjelljes (KS) për mediat e shkruara, siç janë nxjerrë nga Komisioni i Pavarur për Media, respektivisht Këshilli i Mediave të Shkruara, zbatohet ndaj të gjitha aspekteve të prezantimit të fushatës dhe transmetimit të reklamave. Kodet e sjelljes zbatohen për të gjithë transmetuesit, menaxherët e transmetimit, reporterët, gazetarët, redaktorët dhe botuesit.</p> <p>77.2. Të gjitha mediat transmetuese publike emetojnë pa pagesë material për edukimin e votuesve, ashtu siç kërkohet dhe u sigurohet nga KQZ-ja.</p> <p>77.3. Gazetarët, redaktorët, udhëheqësit e transmetimeve, botuesit dhe pronarët e mediave që kandidohen në zgjedhje, nuk kontribuojnë ose përndryshe ndikojnë në përmbajtjen e mediave të tyre përkatëse.</p> <p>77.4. Të gjitha mediat transmetuese dhe të shkruara pranojnë reklamimin me pagesë lidhur me zgjedhjet, në gjuhën(t) në të cilën ato normalisht transmetojnë ose publikojnë.</p> <p>77.5. Publikimi ose përfshirja në</p>	<p>shall be concealed.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER XI MEDIA</p> <p style="text-align: center;">Article 77 General Provisions</p> <p>77 1. The Code of Conduct for Broadcast Media and the Code of Conduct (CoC) for Print Media as issued by the Independent Media Commission or the Press Council of Kosovo, shall be applicable to all aspects of campaign coverage and broadcasting og advertising. This Code of Conduct shall be applicable for all journalists, editors, broadcast managers and publishers.</p> <p>77.2. All broadcast public media shall air voter education material free of charge as requested and provided by the CEC.</p> <p>77.3. Journalists, editors, broadcast managers, publishers and media owners standing as candidates to be elected, shall not contribute to or otherwise influence the content of their respective media.</p> <p>77.4. All broadcasting and print media shall accept paid advertising in the language(s) in which they normally broadcast or publish.</p> <p>77.5. The publication or broadcast coverage of opinion polls and surveys during the campaign period and relating to the elections shall be accompanied by the total number of respondents, the name of</p>	<p>moraju se nositi prikriveno.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE XI MEDIJE</p> <p style="text-align: center;">Član 77 Opšte odredbe</p> <p>77.1. Kodeksi ponašanja prenosnih, (elektronskih), i pisanih medija donošeni od Nezavisne Komisije za medije, odnosno Odbora pisanih medija, primenjuju se obavezno prema svim aspektima izveštavanja o izornoj kampanji. Kodekse ponačanja moraju sprovestinski transmiteri, menadžeri medijskog prenosa, izveštači, novinari, urednici i izdavači.</p> <p>77.22 Sve prenosne medije besplatno prenose materijal za obrazovanje birača koji priprema i obezbeđuje CIK.</p> <p>77.3. Novinari, urednici, upravnici transmitera, izdavači i vlasnici medija koji se kandiduju za izbor, ne smeju na bilo koji način doprineti ili uticati na sadržaj njihovih medija.</p> <p>77.4. Sve elektronske i pisane medijemoraju prihvatiti plaćene izborne reklame na jeziku/cima na koji/ma inače objavljuju/ emituju program.</p> <p>77.5. Objavljivanje ili emitovanje istraživanja javnog mnjenja i anketa u vezi sa izborima u toku izborne kampanje, proračuje se izjavom o ukupnom broju</p>
---	--	--

<p>transmetim të hulumtimeve të opinionit dhe të anketave gjatë periudhës së fushatës dhe që kanë të bëjnë me zgjedhjet përcillet me një deklaratë të numrit të gjithmbarshëm të respondentëve, emrin e kompanisë realizuese, emrin e subjektit politik përgjegjës për atë hulumtim dhe margjinën e gabimit.</p>	<p>the implementing company, the name of the political entity responsible for it, and the margin of error.</p>	<p>ispitanika, nazivom kompanije koja je izvela istraživanje javnog mnjenja, naziv političkog subjekta, odgovornog za istraživanje i verovatnoću.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 78 Qasja e drejtë dhe e paanshme nga mediat gjatë fushatës së zgjedhjeve</p>	<p style="text-align: center;">Article 78 Equitable and Fair Treatment by the Media during the Electoral Campaign</p>	<p style="text-align: center;">Član 78 Pravičan i i nepristrastven odnos medija u toku izborne kampanje</p>
<p>Të gjitha mediat sigurojnë se të gjitha subjektet politike të certifikuara përfaqësohen në mënyrë të drejtë dhe të paanshme në emisionet gjatë fushatës së zgjedhjeve dhe të gjitha mediat transmetuese u sigurojnë të gjitha subjekteve politike të certifikuara qasje të drejtë dhe të paanshme në programet me diskutime politike dhe debate.</p>	<p>All media shall ensure that all certified political entities receive fair and equitable coverage during the electoral campaign, and all broadcast media shall ensure fair and equitable access to political discussion shows and debates for all certified political entities.</p>	<p>Sve medije postaraju se i obezbeđuju da u toku izborne kampanje svi certifikovani politički subjekti budu zastupljeni na pravičan i nepristrastven naćin i da sve elektronske medije svim sertifikovanim političkim subjektima obezbeđuju pravičan i nepristrastven pristup programima sa njihovim političkim raspravama i diskusijama.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 79 Rregullat e përgjithshme për reklamim politik në radio dhe televizion</p>	<p style="text-align: center;">Article 79 General Rules for Political Advertising on Radio and Television</p>	<p style="text-align: center;">Član 79 Opšta pravila o radio/televizijskim političkim reklamama</p>
